

VENDIM
Nr. 343, datë 4.5.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR HARTIMIN E
MODELEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, nenit 36, të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit në sportel të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti përgjegjës për hartimin e modeleve, në kuptim të pikës 1, të nenit 36, të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit në sportel të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë”, është Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

2. Ngarkohet Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama